



Buletini Mjedisor

MINISTRI KOKA PREZANTON APLIKACIONIN "MJEDISI IM"



Reporto abuzimet mjedisore, kjo ishte moto e aplikacionit "Mjedisi Im" prezantuar nga Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka në ambientet e hotel Rognerit në datë 28 Shtator 2015.

"Mjedisi im" ishte një inisiativë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP).

Ky aplikacion është një aplikacion i cili mund të shkarkohet në celularët personal, si dhe në portal online, dhe që synon përfshirjen e qytetarëve në raportimin e shkeljeve mjedisore dhe abuzimeve në mjedis.

Ky aplikacion, është një mënyrë bashkëbisedimi interaktiv midis qytetarëve që do denoncojnë veprimet e paligjshme në mjedis nga njëra anë dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, struktura e cila monitoron zbatueshmërinë e ligjit në të gjitha fushat e Mjedisit, nga ana tjetër.

Ministri i Mjedisit z. Koka në këtë prezantim iu bëri thirrje qytetarëve:

"Mjedisi Im" nuk është thjesht aplikacion raportimi, është zëri juaj, është arma juaj më e fortë. Për të pasur një mjedis të shëndetshëm nuk mjaftojnë vetëm reformat administrative, nuk mjaftojnë penalizimet, nuk mjaftojnë revokimet, por kërkohet parandalim. Mjedisi i shëndetshëm arrihet me përkushtimin tonë, por është i pamundur pa ndërgjegjësimin tuaj si qytetarë të këtij vendi".

Ai i inkurajoi qytetarët në fjalën e tij për ta përdorur këtë aplikacion, i cili është lehtësisht i përdorshëm, pa asnjë kosto financiare për qytetarët.

Në fjalën e tij z. Koka theksoi se "Do të dëshiroja shumë që të gjithë ju, ta përdorni sa më shumë këtë aplikacion, të mund të komunikoni në mënyrë interaktive me ISHMP-në dhe Ministrinë e Mjedisit.

Detyra jonë funksionale është të ruajmë mjedisin shqiptar në të gjithë komponentët e tij. Nëse do të bëheni të gjithë ju, pjesë në këtë aksion të madh për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, unë ju garantoj që brenda këtij mandati, do të mund të bëjmë jo vetëm ato çfarë kemi premtuar në fillim të mandatit tonë, por shumë më tepër se atë. Së shpejti në parlament, do të prezan-

tojmë paketën për ndryshimet në kodin penal, për ndëshkimet e abuzuesve mjedisore.

Pavarësisht punës sonë, realiteti tregon se ne vazhdojmë të kemi prerje pyjesh, vazhdojmë të kemi qytetarë të papërgjegjshëm që me mënyrat më të ndryshme ndotin qytetin, vazhdojmë të kemi aktivitete biznesi të cilat kanë një ndikim negativ në mjedis, ndaj shpejt do të paraqesim në Parlamentin Shqiptar amendime të kodit penal, për parashikimin e një sërë veprash të tjera që konsiderohen krim mjedisor.

Përtej reformave administrative dhe ligjore, theksoj se parandalimi i degradimit mjedisor dhe abuzimeve është sfida dhe detyra kryesore e Ministrisë së Mjedisit, ndaj ju bëj sërish apel të gjithëve, që të raportoni çdo abuzim në këtë aplikacion dhe portal online, me qëllim ruajtjen e së ardhmes së fëmijëve tanë dhe brezave që do të më pas".



PREZANTOHET PROJEKTI IBECA, PROJEKT I BASHKIMIT EUROPIAN NË FUSHËN E MJEDISIT



Ministria e Mjedisit dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në

Tiranë organizuan në datë 29 shtator 2015 konferencën e hapjes së projektit IBECA – Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën.

Objektivi i këtij projekti, i cili vjen si vazhdim i projektit INPAEL dhe SELEA, është të mbështesë punën për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes përmirësimit të kërkesave dhe menaxhimit mjedisor dhe të klimës, duke

bërë të mundur që Qeveria dhe institucionet përkatëse të zhvillojnë, zbatojnë dhe përforcojnë legjislacionin për mjedisin dhe klimën në përputhje me standartet e Bashkimit Evropian.

Projekti ka si qëllim të mbështesë Ministrinë e Mjedisit në zbatimin e legjislacionit për mjedisin dhe klimën përmes: rritjes së efektivitetit të zbatimit të strategjisë për mjedisin dhe klimën, transpozimin dhe zbatimin e legjislacionit evropian për Ndryshimet Klimatike; forcimin e kapaciteteve ligjzbatuese të Inspektoratit Mjedisor, transpozimin e Direktivës për Krimin Mjedisor; përmirësimin e kapaciteteve të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve, në nivel qendror dhe vendor.

Nga Ministria e Mjedisit konferencën e

përhëndeti Sekretari i Përgjithshëm, z. Alqi Bllako, i cili vuri theksin tek sfidat e punës së Ministrisë së Mjedisit për jetësimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm përballë zhvillimit kaotik të Shqipërisë në dy dekadat e fundit dhe rëndësinë jo vetëm të hartimit të legjislacionit për mjedisin dhe klimën, por zbatimit të tij.

Në këtë kontekst, ai vlerësoi kontributin që IBECA pritet të japë në forcimin e kapaciteteve ligjzbatuese veçanërisht në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

IBECA është financuar nga Bashkimi Evropian dhe do të zgjasë 30 muaj.

NË KËTË NUMER:

MINISTRI KOKA PREZANTON APLIKACIONIN "MJEDISI IM" - FQ 1

PREZANTOHET PROJEKTI IBECA, PROJEKT I BASHKIMIT EUROPIAN NË FUSHËN E MJEDISIT - FQ 1

22 SHTATORI 2015 – DITA PA MARINA - FQ 2

LEJET MJEDISORE SHTATOR 2015 – FQ2

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmesja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkë-nduruar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime të mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".



Në periudhën 16-22 Shtator, Bashkimi Europian ndërmer një nismë ndërkomëtare të titulluar “Java Europiane e Qarkullimit”, e cila finalizohet me datën 22 Shtator me ditën “Në qytet pa makinë tme”, e cila ka në fokus reduktimin e përdorimit të makinave private dhe promovimin e alternativave mjedisore në transport.

Veprimtaritë në kuadër të kësaj nisme zhvillohen në të njëjtën kohë në 1136 qytete, në 35 shtete të botës, duke synuar të ndërgjegjësojnë publikun për pasojat negative që shkakton përdorimi i automjeteve në mjedis, si dhe për të inkurajuar zhvillimin e transportit të qëndrueshëm publik.

Shqipëria është bërë anëtare e nismës europiane që prej vitit 2002. Në kuadër të temës së vitit 2015 shpallur nga Bashkimi Europian “Zgjidh. Ndrysho.

Kombino” (Choose. Change. Combine), u organizuan dhe një sërë aktiviteteve në qytetin e Tiranës dhe të Shkodrës.

Kështu në këtë ditë pati një mesazh nga Ministria e Mjedisit drejtuar të gjithë qytetarëve nëpërmjet telefonave të tyre celularë, ku jo vetëm informoheshin për iniciativën Europiane, por dhe u kërkohet që në këtë ditë të përdornin mjete transporti miqësore me mjedisin, si transport publik, biçikleta etj., duke mënjanuar kështu përdorimin e makinave private për distanca të shkurtra.

Mjaft aktive në këtë thirrje të Ministrisë së Mjedisit u tregua dhe stafi i ri i Bashkisë së Tiranës, e cila bllokoi disa nga rrugët kryesore të qendrës së kryeqytetit për t’ia kthyer këto rrugë këmbësorëve dhe çiklistëve.

Në intervistat e dhëna nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës z. Veliq, u la të nënkuptohej se Tirana shumë

shpejt do ishte një qytet i ideuar dhe për këmbësorët dhe çiklistat.

Thirrjes së Ministrisë së Mjedisit drejtuar bashkive të vendit për të ndërmarrë aktivitetet sensibilizuese në këtë ditë, si zakonisht, pozitivisht iu përgjigj dhe qyteti i Shkodrës, qytet me tradita në përdorimin e biçikletës.

Në këtë ditë të shtatorit 2015, me mbështetjen dhe të zyrës së Informimit të Bashkimit Europian në Shkodër u organizuan ecje masive në bulevardin kryesor të Shkodrës.

Në këtë ditë qindra të rinj, por dhe qytetarë dhe aktivistë mjedisorë, zhvilluan ecje demonstrative me biçikleta për t’u treguar përdoruesve të makinave, edhe për distanca të shkurtra, që kjo gjë dëmton shëndetin e të gjithëve.



LEJET MJEDISORE SHTATOR 2015

SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
VËLLEZËRIT HYSA	Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike	Komuna Gostimë, Elbasan	Refuzim	Tipi B
VËLLEZËRIT HYSA	Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike	Komuna Shelcan, Elbasan	Refuzim	Tipi B
MANDI	Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzjerjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i bllqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos	Mëzez, Tiranë	Refuzim	Tipi B
ISA SERDAR	Ndryshim emri	Bërçull	Miratim	Tipi B
ARTI	Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike	Lukovë, Sarandë, Vlorë	Miratim	Tipi B
BAMI	Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3 a ose 7.3 b ose në pika të tjera të kësaj shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi	Krujë, Durrës	Miratim	Tipi B
JODY-KOMPANY	Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3 a ose 7.3 b ose në pika të tjera të kësaj shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi	Fëniq, Delvinë, Vlorë	Miratim	Tipi B
TIREX EXPLORATIONS	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to.	Korçë	Miratim	Tipi B

VIJOJNË DËGJESAT E PUBLIKUT PËR LEGJISLACIONIN MJEDISOR

Vijon zbatueshmëria e Konventës së Aarhusit dhe e legjislacionit mjedisor në lidhje me rritjen e informimit të publikut dhe tërheqjes së mendimit të publikut për legjislacionin mjedisor që hartohet nga Ministria e Mjedisit. Më poshtë po japim shkurtimisht disa prej përmbledhjeve të këtyre dëgjesave që janë zhvilluar gjatë muajit Gusht dhe Shtator 2015.



4 shtator 2015—Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura zhvilluan dëgjesën e katërt publike mbi “Zonimin e Parkut Kombëtar të Alpeve”, me komunitetin dhe grupet e interesit në Vermosh, Bogë dhe Tamarë, ku ishin të pranishëm edhe drejtori i AKZM-së, z. Zamir Dedej, Kryetari i Bashkisë së Malësisë së Madhe, z. Tonin Marinaj dhe përfaqësuesja e Projektit EC-RAN-BE.

Gjatë takimit u prezantua studimi i përgatitur mbi zonimin e Parkut, ku u dëgjuan edhe diskutimet apo propozimet në lidhje me zonimin e brendshëm dhe kufijtë e Parkut Kombëtar të Alpeve. Diskutimi do të mbetet i hapur duke vazhduar dhe në nivele të tjera, pasi do të shqyrtohet nga specialistë të ndryshëm, nga grupet e interesit, derisa projekti mbi “Parkun Kombëtar të Alpeve” të marrë formë të plotë dhe të jetë gati për miratim. Ky është takimi i katërt, i cili zhvillohet për zonimin e këtij parku, pas tre takimeve të mëparshme të zhvilluara në Tiranë, Theth, dhe Valbonë.

Shpallja e Parkut Kombëtar të Alpeve bëhet në zbatim të Programit të Qeverisë dhe prioritetit të Ministrisë së Mjedisit, për shtimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura, duke synuar arritjen e sipërfaqes së zonave të mbrojtura të krahasueshme me mesataren e vendeve anëtare të BE-së. Shpallja e Parkut Kombëtar të Alpeve parashikohet të përfundojë deri në fund të vitit 2015-të, në mënyrë që sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura të shkojë deri në 17% të territorit të vendit, në përputhje me objektivat e Strategjisë së Biodiversitetit të BE-së për periudhën 2011-2020, si dhe në kuadër të zbatimit të “Aichi Targets” të Konventës së Biodiversitetit.

Zgjerimi i kësaj zone, duke nisur nga Vermoshi deri në Valbonë, që do të jetë Parku Kombëtar i Alpeve, duke përfshirë ndër të tjera edhe dy parqet kombëtare ekzistuese; Parkun Kombëtar të Thethit dhe atë të Luginës së Valbonës. Parku Kombëtar i Alpeve do të ketë një sipërfaqe të propozuar prej 86

mijë hektarësh dhe do të jetë më i madhi në rang vendi.

Krijimi i Parkut Kombëtar të Alpeve është me rëndësi të veçantë, pasi do të shërbejë si bazë për krijimin e zonës së parë të mbrojtur ndërkufitare tripalëshe me Malin e Zi dhe Kosovën.

28 Gusht 2015 - Ministria e Mjedisit me mbështetjen e UNDP-së organizoi dëgjesën e publikut për Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. Në këtë takim mermin pjesë përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, z. Zamir Dedej, si dhe përfaqësues të shoqatave mjedisore.

Gjatë takimit, përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit shprehën rëndësinë e hartimit të Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan, duke vënë theksin jo vetëm në cilësinë e këtij plani menaxhimi, por dhe në procesin e hartimit të tij, i karakterizuar nga konsultimet të vazhdueshme me grupet e interesit.

Në fjalën e saj znj. Violeta Zuna, koordinatore e Projektit “Përmirësimi i mbulimit dhe efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare” në UNDP, prezantoi objektivat që synon ky plan menaxhimi, duke theksuar se ky është i pari plan i menaxhuar detar, që hartohet në Shqipëri dhe si i tillë merr një vlerë të veçantë. Përfaqësuesja e UNDP-së u shpreh se krijimi i zyrave lokale për zonat e mbrojtura është një hap mjaft i rëndësishëm që i hap rrugën implementimit të këtij plani menaxhues.

Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan është hartuar bashkarisht nga WWF Mediterranean Program” dhe Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “INCA”, në kuadër të Projektit “Përmirësimi i mbulimit dhe efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare”, financiar nga UNDP. Zbatimi i tij do të realizohet nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, e cila me punën e saj do ta shndërrojë këtë Plan Menaxhimi në dokumentin e planifikimit strategjik të Administratës së Zonës së Mbrojtur për 10 vitet e ardhshme.

Më **14 Gusht 2015**, Ministria e Mjedisit me mbështetjen e Bashkimit European, GIZ dhe UNDP organizoi dëgjesën e publikut për raportin teknik “Kontributi kombëtar i pikësnyuar”, që Shqipëria duhet të prezantojë në takimin COP 21, që do të mbahet në Paris.

Takimi u hap nga znj. Laureta Dibra, përgjegjëse e Sektorit të Ajrit dhe të Ndryshimeve Klimatike në

Ministrinë e Mjedisit, e cila pasi falenderoi të pranishmit për prezencën e tyre shprehu rëndësinë e hartimit të këtij kontributi kombëtar që do ndikojë në uljen e emtimeve në ajër për vitet në vazhdim. Znj. Dibra e vlerësoi ndihmën e dhënë dhe punën e bërë nga ekspertët ndërkombëtarë. Gjithashtu theksoi se ky dokument është mjaft ambicioz për Shqipërinë dhe kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces për arritjen e kërkuar të objektivave nga vendi ynë, si një vend që aspiron të jetë pjesë e Bashkimit European.

Më pas fjalën e mori z. Gjergj Simaku, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Energjetike të Rinovueshme dhe Eficiencës Energjetike, në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, i cili shprehu në mënyrë të përmbledhur problematikën që ka Shqipëria në këtë proces të rëndësishëm të ndryshimeve klimatike, sidomos në fushën e energjisë dhe e transportit, fusha që duhet të reagojnë në lidhje me procesin e ndryshimeve klimatike.

Më pas, konsulenti z. Jozsef Feiler bëri një prezantim të procesit për takimin e COP 21, që do të mbahet në Paris dhe opsione të mundshme të INDC. Në prezantimin e tij z. Feiler theksoi se ky material i përgatitur nuk është një raport i zakonshëm, por ky është hapi i parë që bën Shqipëria drejt arritjeve të standarteve të Bashkimit European për nivelin e emtimeve të gazeve serë.

Më pas, pati një prezantim nga znj. Agnes Kelement, e cila i njohu të pranishmit me skenarët e e çlirimeve të gazeve serë, që mund të aplikohen në Shqipëri në fushën e transportit, energjisë dhe bujqësisë, si dhe gjetjet gjatë këtij procesi. Znj. Kelement iu shpjegoi të pranishmëve që të dhënat në Shqipëri shpesh ishin të pamjaftueshme dhe jo shumë të besueshme. Përfundimi nga analiza e të dhënave rezultonte që skenari që mund të përdorej në Shqipëri ishte hibrid, në varësi të të dhënave që ofroheshin.

Më pas znj. Heather Haydock, eksperte GIZ në Shqipëri prezantoi për të pranishmit analizën kosto-përfitim të INDC në Shqipëri. Në përfundim të takimit, u kërkua nga të pranishmit që të dërgojnë komentet në lidhje me materialin e hartuar për t’u riparë në materialin që do t’u përcillet Ministrive të linjës.



FILLON ZHVILLIMI I ORËVE TË HAPURA MJEDISORE NË 90 SHKOLLAT NËNTËVJEÇARE



Edukimi mjedisor është procesi që i ndihmon nxënësit të njihen me çështjet mjedisore, të përfshihen në zgjidhjen e tyre dhe të ndërmarin nisma për përmirësimin e gjendjes mjedisore. Për pasojë nxënësit zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë ata të marrin vendime të përgjegjshme për mjedisin dhe shoqërinë.

Është kjo arsyeja që Ministria e Mjedisit për vitin akademik 2015-2016, ka ndërmarrë një iniciativë për të zhvilluar në 90 shkollat nëntëvjeçare të të gjithë vendit, orë të hapura mjedisore.

Fillimisht, këto orë të hapura, janë zhvilluar në fund të muajit shtator, në bashkinë dhe rrethinat e qytetit të Bajram Currit, për të vijuar më pas në klasat e pesta të bashkisë së Kukësit.

Këto orë të hapura janë ideuar të zhvillohen në klasën e pestë të shkollave nëntëvjeçare, duke marrë

parasysh që deri në këtë moshë fëmijët kanë marrë elementët bazë të mjedisit. Gjatë këtyre orëve mundësohet dhënia e njohurive të përgjithshme për mjedisin dhe më specifikisht për fushën e ujit, biodiversitetit dhe mbetjeve. Orët e hapura janë organizuar në formë interaktive, ku fëmijët të jenë pjesëmarrës aktivë në njohuritë që jepen nga stafi i Ministrisë së Mjedisit.

Por ajo që është më e rëndësishme, përveç pjesës teorike, që iu jepet në fillim fëmijëve, është pjesa e demonstrimit të sjelljeve mjedisore, që ata duhet të përvetësojnë në fund të kësaj ore të hapur.


Këto orë të hapura zhvillohen në vijim të punës për zbatimin e Programit Kombëtar të Edukimit Mjedisor, që ka hartuar Ministria e Mjedisit dhe është nënshkruar në Shkurt 2014 nga të dy Ministrat përkatës, nga Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Arsimit.

Ky program i edukimit mjedisor është hartuar që të shërbejë si një udhërrëfyes për shkollat, mësuesit dhe nxënësit, për të hartuar dhe zhvilluar programe edukuese mjedisore, që të pajisin nxënësit me njohuritë dhe shprehjet e nevojshme për pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme në menaxhimin e mjedisit, nxënës që kuptojnë rëndësinë e përkujdesjes kundrejt mjedisit dhe minimizimit të ndikimit njerëzor mbi të, në shkëmbim të garantimit të një jetë më të mirë për të tashmen dhe brezat e ardhshëm.



VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS SHTATOR 2015

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	Ejona Zaimaj	VP Ndërtim stalle	Prashbull, Durrës	Vendim për VNM Paraprake
2	Geo-Kan	VTH Shfrytëzim guri	Kaninë, Vlorë	Deklaratë Mjedisore
3	Abcom	VP Ndërtim infrastrukture kablore	Berat	Refuzim
4	Dhimitraq Tona	VP Prodhim birre	Lagja 6, Korçë	Vendim për VNM Paraprake
5	Ilija Dule	VP Kompleks blegtoral	Goranxi, Gjirokastër	Vendim për VNM Paraprake
6	Amal	VP HEC	Xhyrë, Librazhd	Refuzim
7	Primagas Albania	VP Depozita siperfaqësore gaz natyror	Porto Romano, Durrës	Vendim për VNM Paraprake
8	Arkev	VTH Shfrytëzim kromi	Martanesh, Bulqizë	Refuzim
9	Klebota	VP Prodhim birre	Tomin, Dibër	Vendim për VNM Paraprake
10	Enti Kombëtar i Banesave	VP Kompleks banesash sociale	Librazhd	Vendim për VNM Paraprake
11	Elkri & CO	VP Ndërtim kapononi industrial	Metaq, Sarandë	Vendim për VNM Paraprake
12	Prima Konstruksion 3914	VP Ndërtim kapononi industrial	Vllahat, Sarandë	Vendim për VNM Paraprake
13	Prima Konstruksion 3915	VP Ndërtim kapononi industrial	Vurgu i Ri, Sarandë	Vendim për VNM Paraprake
14	Prima Konstruksion 3948	VP Ndërtim i dhomes frigoriferike	Kullirice, Sarandë	Vendim për VNM Paraprake
15	Pro-Fast	VP Ndërtim shtese godine për thetore	Boboshtice, Korçë	Vendim për VNM Paraprake
16	Balkan Basalt	VTH Shfrytëzim ranoresh (Ndryshim adrese selie)	Orosh, Mirditë	Deklaratë Mjedisore
17	Këshilli i Qarkut Vlorë 4038	VP Krjimi i një shtegu "Trekking" në kanyonet e Gjipesë	Gjipe, Vlorë	Vendim për VNM Paraprake
18	Këshilli i Qarkut Vlorë 4039	VP Pikë panoramike dhe sportive	Llogara, Vlore	Vendim për VNM Paraprake
19	Këshilli i Qarkut Vlorë 4041	VP Krjimi dhe rehabilitimi i pikës së vrojimit Porto-Palermo	Porto Palermo, Vlorë	Vendim për VNM Paraprake
20	OSHEE 4080	VP Rikonstruksion i rrjetit të ri ajror	Durrës	Vendim për VNM Paraprake
21	OSHEE 4081	VP Ndërtimi i rrjetit TU dhe ndërtim kabine	Rromanat, Shijak, Durrës	Vendim për VNM Paraprake
22	OSHEE 4083	VP Spostim kabine	Durrës	Vendim për VNM Paraprake
23	Bashkia Çorovodë	VP Rikonstruksion dhe ndërtim veprash në kanyonet e Osunit	Çorovodë, Skrapar	Vendim për VNM Paraprake
24	Delta Konstruksion	VP Shtesë Kapononi	Durrës	Vendim për VNM Paraprake
25	Jonardo Konstruksion	Kompleks turistik	Velipojë, Shkodër	Refuzim



THËNIA E MUAJIT

“Përfytyroni sikur pemët të lëshonin sinjale WiFi... me siguri që ne do të mbillnim aq shumë pemë, sa do ta shpëtonim planetin.

Sa keq që ato lëshojnë vetëm oksigjenin që ne thithim!!”

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE



TË DREJTAT MJEDISORE ME KOMUNITETIN E PREKUR NGA NDOTJA INDUSTRIALE

Në kuadër të projektit "Së bashku, një sy për mjedisin"

financuar nga Qeveria Suedeze dhe mundësuar nga një grant i REC Shqipëri, Qendra Aarhus Shkodër në bashkëpunim me Klubin Ekologjik Elbasan realizuan një trajnim mbi të drejtat mjedisore dhe Konventën e Aarhusit me komunitetin e prekur nga ndotja industriale në Komunën Papërr të Elbasanit.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin përfaqësues nga shoqëria civile, komuniteti, institucionet, stafi mjekësor dhe media.

Zona e Paprrit është një zonë e industrializuar prej kohësh, ku gjendet ish-fabrika e çimentos dhe ish-rafineria e naftës. Këto industri nuk janë më funksionale, por vazhdojnë të jenë zona të nxehta të ndotjes mjedisore, për shkak të prezencës së substancave që vazhdojnë të ndosin ajrin dhe tokën.

Për më tepër, zona vuan edhe ndikimin nga fabrika e Kurumit dhe Ferrokromi. Për fat të keq, problematika mjedisore e për rrjedhojë edhe ajo shëndetësore në këtë zonë është e lartë, duke qenë se rreth 1000 banorë jetojnë krejt afër këtyre industrive.

Gjatë takimit, banorët shprehën shqetësimin e tyre për situatën dhe problemet shëndetësore, për të ardhmen e zonës, por edhe ndjesinë e pafuqisë së komunitetit për të ndryshuar të ardhmen e tyre. Doktorësja e Qendrës Shëndetësore të Vigasit (në komunën Papërr), Znj. Hedije Hoxha u shpreh shumë e shqetësuar se "ne kemi nivelin më të lartë të vdekshmërisë në të gjithë Shqipërinë. Elbasani rezultoi si qyteti me nivelin më të lartë të sëmundjeve kancerogjene në Shqipëri".

Nga ana tjetër një organizatë mjedisore lokale shprehu shqetësimin për ndërgjegjësimin e mangët të vetë komunitetit për të kërkuar të drejtën e tyre për një mjedis të më të përshatshëm.

Në këtë kontekst, Qendra Aarhus Shkodër informoi të pranishmit për të drejtat mjedisore, që ata kanë sipas legjisllacionit shqiptar dhe parimeve të Konventës së Aarhusit, për rrugët që komuniteti mund të ndjekë për të vënë institucionet shtetërore para presionit dhe përgjegjësisë për të rehabilituar dhe përmirësuar mjedisin dhe jetën e tyre.

Alminda Mema, drejtuese e Qendrës Aarhus Shkodër u shpreh se "është shumë e rëndësishme që komuniteti të organizohet, të veprojë dhe të kërkojë të drejtat, ta kthejë problematikën mjedisore në një prioritet të instancave shtetërore".

Për t'i ardhur në mbështetje komunitetit gjatë takimit u realizua edhe një simulim mbi mënyrën sesi mund t'i drejtohem institucioneve me anë të shkresave zyrtare. Po ashtu, si Klubi Ekologjik Elbasan, ashtu dhe Qendra Aarhus Shkodër, shprehën gadishmërinë për të mbështetur këtë komunitet në nismat e tyre për të përmirësuar situatën në të cilën jetojnë.

SENIOR-A.

Ishulli Ekologjik, u inagurua si një risi në qytetin e Vlorës për ndarjen e diferencuar dhe riciklimin e mbetjeve urbane si plastika, qelqi, letra dhe metalet, mbetje këto për të cilat ekziston tregu i riciklimit në Shqipëri.

Kjo iniciativë u realizua nga bashkëpunimi i suksesshëm i Qendrës së Aarhusit Vlorë me stafin e Bashkisë së Vlorës dhe Organizatën EMMAUS Vlorë. Në aktivitetin e zhvilluar mori pjesë Kryetari i Bashkisë Vlorë, z. Dritan Leli, si dhe përfaqësues të Insitucioneve Publike Vendimmarrëse, aktivistë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Dita e vendosjes së koshave të diferencuar erdhi pas një pune të gjatë ndërgjegjësuere me banorët e të gjithë zonës për të shpjeguar ndarjen në kosh, si dhe për të ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe mbështetjen që banorët duhet t'i japin këtij projekti.

Kryetari i Bashkisë, z. Leli në këtë ditë pyeti të rinjtë se si i kishin pritur banorët e lagjes "Isa Boletini". "Shumica e tyre ishin dashamirës dhe mbështetës të iniciativës, por pse ta mohojmë patë edhe ndonjë rast ku nuk na pritën mirë" ishte përgjigja e Klejdja Dalipaj, vullnetare e Organizatës.

"Nismat e shoqërisë civile, janë gjithmonë të mirëpritura dhe do të gjejnë përkrahje maksimale nga Bashkia Vlorë, sepse këto nisma janë në favor të komunitetit dhe mbrojtjes së mjedisit" – u shpreh z. Leli në fjalën e tij përsëhendëse.

ISHULLI EKOLOGJIK NË LAGJEN 'ISA BOLETINI' VLORË

Krijohet në një lagje të Vlorës "Ishulli ekologjik", ku do të bëhet ndarja e diferencuar e mbetjeve. Ky projekt u mundësua nga Qendra Aarhusit Vlorë me financim të Qendrës Rajonale Mjedisore (REC Shqipëri) në kuadër të programit

